



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Tiranë, më 04.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: “Blerje pajisje zyre për M.E.K.I”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 39150000-8 (Mobilje dhe pajisje te ndryshme)

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS: “Blerje pajisje zyre për M.E.K.I” me vlerë të përgjithshme të fondit limit në vlerën 8.333.210 (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e dhjetë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin*

permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit është nën vlerën e kufirit të ulët monetar.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit** .Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të

deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

- 2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:
 - Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalent; (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015).
 - Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalent; (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. ISO 14001-2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Keto certifikime kerkohen per te vertetuar se OE eshte nje kompani serioze ne treg e cila zbaton standardet e cilesise dhe rregullat e menaxhimit te mjedisit sipas legjislacionit te prokurimeve, legjislacionit te punes dhe atij mjedisor ne RSH. Veme re se legjislacioni i PP i jep nje rendesi te posacme prokurimit te gjelber dhe pergjegjesise sociale te AK-ve dhe OE.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 5 (pesë) punonjës të cilet duhet të figurojnë në listepagesën e punonjesve të konfirmuar nga autoriteti përkatës sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky numer punonjeshish kërkohet për të vertetuar se OE ofertues ka një numer minimal punonjeshish për të realizuar kontratën bazuar edhe në sasine e mobiljeve që kërkohen të levrohen, afatit të levritimit dhe vlerës së fondit limit të kontratës.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën:

1. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën:

- 1 (një) inxhinier druri ose arkitekt vërtetuar me:

1. kontratën individuale të punës ose bashkëpunimi (te vlefshme);
2. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

- 1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh vërtetuar me:

1. kontratën individuale të punës ose bashkëpunimi (te vlefshme);
2. certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;

- 1 (një) shofer vërtetuar me:

1. kontratën individuale të punës ose bashkëpunimi (te vlefshme);
2. leje drejtimi

- 2 (dy) punonjës për montim, asamblimin apo transportin e mallrave vërtetuar me

kontratën individuale të punës ose bashkëpunimi (te vlefshme);

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjësit me specialitet e sipër-permendura kerkohen ne perputhje te plote me objektin e prokurimit, me konkretisht:

1. Nje inxhinier druri ose arkitekt – zerat 1-5 jane mobilje te cilat do te prodhohen/asamblohen sipas permasave te kerkuara nga AK. Profesionistet per te realizuar porosine e prodhimit apo mbikqyrjen e procesit prodhimit ose asamblimit, montimit qe mobiljet te jene sipas specifikimeve teknike me ane te renderit apo menyrave te tjera teknike jane inxhinieri i drurit duke qene se pjesa me e madhe e mobiljeve jane me materiale druri ose imitime te tij ose arkitekti i cili ka njohuri per te gjithë procesin e projektimit, prodhimit, asamblimit, etj.
2. 1 nje marangoz/ mobilier ose montues mobiljesh- zerat 1-5 jane mobilje te cilat do te prodhohen/asamblohen sipas permasave te kerkuara nga AK. Profesionistet te cilet kane eksperiencen dhe njohurine teknike per keto veprimtari jane marangozi, mobilieri ose montuesi i mobiljeve. Ky punonjes ka nje rol kyc ne zbatimin e kontrates.
3. Punonjesit e tjere si shoferi dhe punonjesit e thjeshte jane te domosdoshem per transportin dhe punen ndihmese qe do te kryhet pergjate te gjithë proceseve te zbatimit te kontrates.

Shenim: Ky numer punonjesish eshte nje numer minimal qe OE ofertues jo vetem prodhues por edhe tregetes duhet te kene per zbatimin e kontrates. Kerkesa qe keta punonjes te jene te punesuar prane OE eshte nje siguri qe OE do e realizoje me sukses kontraten. Ne cdo rast edhe kur OE nuk eshte vete prodhues duhet te kete stafin minimal per realizimin e porosive sipas Specifikimeve Teknike te kerkuara nga AK. Objekti i ketij prokurimi eshte ”mallra” por keto mallra, ne pjesen me te madhe te tyre nuk gjenden ne treg me permasat fikse qe kerkohen nga AK, pra kjo kontrate ka si procese projektimin (renderat), prodhimin ose porosine e cila behet sipas Specifikimeve Teknike tek nje prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin tek AK dhe vendosjen e tyre ne ambientet e AK sipas Specifikimeve Teknike.

5. Operatori ekonomik duhet te kete nje ambient ku ushtron veprimtarine sipas objektit te prokurimit, prodhim ose shitje/ tregetim/ mobilje/ pajisje zyre, per te cilen duhet te paraqese:

- akt pronesisë, kontrate qiraje apo perdorimi i regjistruar ne Qkb si ambient ku ushtron aktivitetin.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter vendoset ne perputhje te plote me objektin e prokurimit pasi sic kemi permendur dhe me lart OE ofertues mundte jete jo vetem prodhues por edhe tregetes dhe per kete qellim duhet te kete ambientin e posacem per zbatimin zbatimin e kontrates. Objekti i ketij prokurimi eshte ”mobilje” dhe qofte per prodhimin apo edhe tregetimin e tyre OE-te duhet te kene nje ambient te posacem per kete veprimtari.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedën teknike për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat oferton ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit/mallrave që do të ofrohen, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për zerat e preventivit 7,8, dhe 9 deklarate ku të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë sipas konformitetit CE.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

Ky kriter vendoset për arsye të kërkesës për cilësi të mallrave (karrige, poltrone) për stafin e AK-MEKI.

8. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 vjetecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit. Çdo prodhues ose distributor shitës ofron garanci për mallrat për një afat të caktuar. AK-ja ka kërkuar garanci me afatet e mësipërme sipas tipologjisë së mallrave e cila mbulon defekte (probleme) që vijnë nga prodhimi pas blerjes.

9. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit dhe montimin e mallrave pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin dhe vendosjen e tyre në gjendje të plotë përdorimi (duke përfshirë montimin, nëse është rasti), në adresën e autoritetit kontraktor.

10.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e AK përfitues dhe organit qendror blerës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara nga Organi Qendror Blerës, të publikuara në faqen zyrtare të Operatorit Blerjeve të Përqendruara www.obp.al, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

NJESIA E PROKURIMIT